



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 573/25 Dt. 24.09.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas shqyrtimit të kërkesës 01-030 nr. 126125, datë 18.09.2025, të Shoqatës “Gratë Burrnesha”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 126125, datë 18.09.2025 e Shoqatës “Gratë Burrnesha”, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth organizmit të aktiviteteve me rastin e Muajit Rozë (tetor 2025), kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve rreth këtij organizimit dhe mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të personaliteteve të fushës së onkologjisë nga Republika e Turqisë të cilët do të marrin pjesë në këtë aktivitet, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



➤ Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Shoqatës “Gratë Burrnesha”,
- Arkivës së Kryetarit.